



SHE | Non-Governmental
Solutions | Organization

Rr.Xhemajl Mustafa, BB-1, II.5, Nr. 14
Fiscal Number:
602528145
+383 44 145 063
ojq.she.solution@gmail.com

Strategjia e SHE Solutions / AJO Zgjidhje 2023-2028

Kjo strategji është mundësuar falë mbështetjes organizative të Fondit të Grave të Kosovës (FGK), përmes Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) dhe është financuar nga Sigrid Rausing Trust (SRT). Përbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e SHE Solutions dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e SRT apo RrGK.

© SHE Solutions, nëntor 2023

**THE
SIGRID
RAUSING
TRUST**



Përmbajtja

| | | |
|-------|---|----|
| I. | Hyrje..... | 3 |
| II. | Vizioni dhe misioni i SHE Solutions / AJO Zgjidhje | 3 |
| III. | Misioni | 3 |
| IV. | Orientimet Strategjike | 5 |
| | 1. Fuqizimi, mbështetja dhe promovimi i grave në pozita vendimmarrëse..... | 6 |
| | Objektiva Specifike 1.1 Rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe proceset vendimmarrëse | 6 |
| | Objektiva Specifike 1.2 Rritja e mbështetjes së grave asambleiste në nivelin komunal në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun | 6 |
| | Objektiva Specifike 1.3 Rritja e mbështetjes së grave deputete dhe fuqizimi i Grupit të Grave Deputete përmes menaxhimit të marrëdhënieve me publikun. | 7 |
| | 2. Përkrahja dhe promovimi i grave në sektorin e sigurisë | 7 |
| | Objektiva Specifike 2.1 Rritja e mbështetjes së grave në sektorin e sigurisë..... | 7 |
| | Objektiva Specifike 2.2 Rritja e vetëdijesimit rreth kontributit të grave në sektorin e sigurisë | 8 |
| VI. | Monitorimi dhe Vlerësimi..... | 8 |
| VII. | Plani i menaxhimit të rrezikut | 11 |
| VIII. | Gjithëpërfshirja..... | 12 |
| IX. | Operacionalizimi i Strategjisë | 13 |
| X. | Plani i Veprimit | 14 |
| | Aneks A-Kodi i Mirësjelljes..... | 18 |
| | Aneks B-Organogrami | 19 |

I. Hyrje

Gjatë pesë viteve 2023-2028, OJQ-ja SHE Solutions / AJO Zgjidhje, është e përkushtuar në avancimin dhe fuqizimin e grave dhe të promovojë praninë e tyre në pozita vendimmarrëse brenda sferës së politikës, sigurisë dhe fuqisë punëtore. Strategjia e tanishme gjithëpërfshirëse përfshin iniciativa të shumta të përshtatura për të arritur këtë qëllim.

Pas iniciativave të ndryshme sikurse zgjedhjet e nivelit lokal dhe qendror kanë shënuar një përmirësim të dukshëm nga vitet e mëparshme sa i përket përfaqësimit të grave në politikë. Megjithatë, ky numër vazhdon të ndryshojë duke demonstruar nevojën për përpjekje të vazhdueshme për të siguruar përfaqësimin politik të grave dhe grave në pozita vendimmarrëse.

Sidomos në sektorin e sigurisë, gratë janë përballur me barriera të ndryshme, duke reflektuar natyrën tradicionalisht të dominuar nga burrat në këto profesione. Sektori i sigurisë në Kosovë gradualisht i ka integruar gratë në radhët e saj, edhe pse numri i tyre mbetet relativisht i ulët sidomos në pozita vendimmarrëse. Hulumtime të ndryshme kanë reflektuar se prezenca e grave në sektorin e sigurisë dhe në pozita vendimmarrëse paraqet një stabilitet më të madh dhe qëndrueshmëri. Barrierë e kësaj normalisht mbeten paragjykimet më bazë gjinore dhe barrierat institucionale si dhe largimi ndër vite i grave nga sektori i sigurisë.

Për të adresuar këto sfida, Kosova ka zbatuar iniciativa për të promovuar integrimin gjinor në institucionet e sektorit të sigurisë, duke përfshirë kuota, programet e trajnimit dhe ndërgjegjësimit. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, ka ende punë për të bërë për të arritur barazinë gjinore dhe për të krijuar një sektor sigurie më gjithëpërfshirës. Ndërkohë që janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm, kërkohen përpjekje të vazhdueshme për të thyer barrierat, për të sfiduar normat tradicionale gjinore dhe për të promovuar përfshirjen e grave në formësimin e sektorit politik dhe të sigurisë. Arritja e barazisë gjinore në këta sektor nuk është vetëm çështje e të drejtave të njeriut, por është gjithashtu jetike për stabilitetin afatgjatë, prosperitetin, si dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë.

II. Vizioni dhe misioni i SHE Solutions / AJO Zgjidhje

Vizioni i SHE Solutions/AJO Zgjidhje, parasheh krijimin e mundësive të barabarta për gratë si dhe për burrat në Kosovë. Andaj synim parësor e ka fuqizimin e vajzave dhe grave në vendimmarrje dhe ngritjen e vetëdijes për përfaqësimin më të madh të grave në pozita vendimmarrëse dhe në sektorin e sigurisë përmes aktiviteteve të ndryshme.

III. Misioni

Misioni i OJQ-së SHE Solutions/AJO Zgjidhje, është fuqizimi i vajzave dhe grave në vendimmarrje, fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri dhe në të gjitha fushat. Misioni i SHE Solutions/AJO Zgjidhje është dhe që të përkrahë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në tërë Kosovën pa dallim në baza politike, fetare, moshës apo etnisë. Këtë mision organizata synon dhe punon në vazhdimësi që ta arrij përmes: lobimit, hulumtimeve, organizmit dhe pjesëmarrjes në tryeza të ndryshme si dhe realizimit të intervenimeve të ndryshme vetëm ose në bashkëpunim me partnerë të tjerë. Intervenime këto si trajnime, mentorime, hulumtime, informime si dhe mbështetje direkte.

Organizata është e përkushtuar në lobimin për respektimin dhe përfshirjen e grave dhe vajzave në çdo sektor si dhe promovimin e rëndësisë së rolit të tyre në fusha dhe profesione të ndryshme. Zhvillimi i hulumtimeve për të kuptuar pasqyrën e gjendjes në secilin sektor, e ndihmon organizatën të identifikojë vështirësitë dhe sfidat, e njëherit e informon atë për mundësitë e adresimit të këtyre sfidave dhe përkthimin e tyre në intervenime konkrete.

Përmes organizimit dhe pjesëmarrjes në tryeza dhe punëtori të ndryshme organizata thekson në vazhdimësi rëndësinë dhe nevojën e gjithëpërfshirjes gjinore në procese dhe sektor të ndryshëm. Ndërsa me planifikimin dhe ndërmarrjen e intervenimeve si trajnime, fushata promovuese dhe mbështetje direkte për grupe të ndryshme, organizata synon të dëshmojë mundësinë e përmirësimit të pozitës së vajzave dhe grave në sektorë të ndryshëm dhe të ndikojë në avansimin e vazhdueshëm të përfaqësimit të tyre.

Ky mision do të realizohet përmes mbështetjes direkte në marrëdhëniet me publikun, në komunikim dhe avokim për të zhvilluar më tutje çështjet me interes për respektimin dhe zbatimin e ligjit për barazi gjinore dhe me anë të kësaj të promovohen të drejtat dhe përfaqësimi më i madh i grave në pozita vendimmarrëse në mënyrë që të arrihet barazia gjinore në vendim-marrje, përfaqësim si dhe në përfshirjen shoqërore.

Për të bërë të mundur realizimin e objektivave që vajzat dhe gratë të jenë vlerë dhe jo vetëm numër, shpeshherë ashtu të perceptuara, në institucionet në të cilat ato punojnë për përmbushjen minimale të kuotës, SHE Solutions, me veprimtarinë e vetë synon të krijojë mekanizma ku gruaja do të konsiderohet faktor kyq, çelës, për zgjidhjen e të gjitha sfidave që paraqiten nga perceptimet dhe stereotipet gjinore në shoqërinë tonë për gratë në vendimmarrje. SHE Solutions, përmes aktiviteteve reflekton rëndësinë që ka gruaja dhe vajzat, në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të shoqërisë dhe krijimit të qëndrueshmërisë në fushat e ndryshme të jetës publike, ekonomike, sociale dhe politike.

Angazhimi për barazi gjinore, për mundësi dhe të drejta të barabarta të grave dhe burrave nuk është risi në shoqërinë tonë, por ka shumë punë për tu bërë në ndryshimin e perceptimit të asaj çfarë paraqet barazia gjinore dhe përfaqësimi i grave në pozita vendimmarrëse.

Me qëllim të përmbushjes së këtij misioni SHE Solutions / AJO Zgjidhje, ka hartuar orientimet strategjike, të cilat kanë një qëllim kryesor të krimit të një shoqërie ku burrat dhe gratë kanë mundësi në mënyrë të barabartë për arsim, punësim, pjesëmarrje në tregun e punës, përfaqësim në pozita vendimmarrëse në të gjitha fushat dhe kanë mundësi të i zbatojnë këto të drejta në praktikë. Për zbatimin e efektshëm të aktiviteteve drejtë përmbushjes së vizionit dhe misionit të lartëpërmendur, SHE Solutions/AJO Zgjidhje ka hartuar Strategjinë 2023-2028 në të cilën bazohen orientimet strategjike si dhe aktivitetet për këtë periudhë kohore.

Anëtarët si dhe Bordi Drejtues të konsultuar në hartimin dhe aprovimin e kësaj strategjie, si dhe partnerët relevant dhe palët financuese të She Solutions do të ofrojnë mbështetjen e tyre në zbatimin e aktiviteteve të kësaj strategjie në këto dy fusha programatike:

1. Fuqizimi, mbështetja dhe promovimi i grave në pozita vendimmarrëse;
2. Përkrahja dhe promovimi i grave në sektorin e sigurisë;

IV. Orientimet Strategjike

SHE Solutions / AJO Zgjidhje, synim parësor e ka fuqizimin e vajzave dhe grave në të gjitha fushat ekonomike dhe shoqërore, me fokus në vendimmarrje. Kjo duke pasur parasysh nevojën për mbështetje në marrëdhëniet me publikun, në komunikim dhe avokim për të zhvilluar më tutje çështjet me interes dhe për të bërë të mundur realizimin e objektivave që gratë të kenë në praktikë qasje dhe mundësi të ndikojnë në proceset vendim-marrëse si në institucione publike, shoqërinë civile, media ose ndërmarrësi. Përdorimi i marrëdhënieve publike dhe aktiviteteve të ndryshme që rrisin vetëdijesimin e masave dhe përçojnë vlera të një shoqërie të zhvilluar ku gratë janë pjesë e vendimmarrjes dhe pozitive të larta në fusha të ndryshme do të bazohet po ashtu në platforma të komunikimit masiv dhe mediave sociale për arsye të ndikimit që kanë në shoqërinë bashkëkohore.

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore¹ shërben si bazë për Strategjinë e She Solutions/ Ajo Zgjidhje. Programi në fjalë është një plan strategjik i qeverisë së Kosovës, ku përshkruhen objektivat, veprimet dhe akterët kryesorë të ngarkuar për hapat drejt arritjes së barazisë gjinore në sferat politike, shoqërore, ekonomike, shëndetësore dhe kulturore në Kosovë. Objektivat e mëposhtme kontribuojnë në tre shtyllat e cekura brenda Programit (PKBGJ). Më specifikisht objektivat e mëposhme dhe strategjia në përgjithësi ka për bazë aktivitete dhe synimin e zhvillimit të hapave drejt përmbushjes së Shtyllës I: "Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale", Shtyllës II: "Zhvillimi Njerëzor, Rolet, dhe Marrëdhëniet Gjinore", dhe Shtyllës III: "Të Drejtat e Grave, Qasja në Drejtësi dhe Siguria"².

Strategjia e She Solutions/Ajo Zgjidhje kontribuon dhe bazohet në objektivat të Zhvillimit të Qëndrueshëm të (SDG 5): Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave³. Strategjia dhe objektivat në fjale kontribuojnë direkt në tre nga synimet e objektivit 5, respektivisht;

- 5.1 Dhënia fund të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave kudo,
- 5.5 Sigurimi i pjesëmarrjes së plotë dhe efektive të grave dhe mundësive të barabarta në pozicione drejtuese në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike
- 5.b Rritja e përdorimit të teknologjisë mundësuese, në veçanti e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për të promovuar fuqizimin e grave

Duhet specifikuar po ashtu dhe Plani i Veprimit Gjinor (PVGj) III të BE-së⁴, i cili pasqyron objektivat kryesore të Strategjisë së BE-së për Barazinë Gjinore. Strategjia e She Solutions/Ajo Zgjidhje kontribuon në Shtyllën 3 të PVGj III të BE-së, në pikën katër "Avancimi të barabartë në pjesëmarrje dhe udhëheqje", dhe në pikën pesë "Integrimi Agjendës Gratë, Paqja dhe Siguria", ku parashihet dhe ngritja e përfaqësimit të grave në sektorin e sigurisë⁵.

¹ Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ABGJ%20Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20p%C3%ABr%20Barazi%20Gjinore%202020-2024.pdf>.

² Ibid.

³ Kombet e Bashkuara, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, <https://kosovoteam.un.org/sq/sdgs/5>.

⁴ Bashkimi Europian, Plani i Veprimit Gjinor III, [file:///C:/Users/andra/Downloads/Gender Action Plan putting women and girls rights at the heart of the global recovery for a gender-equal world.pdf](file:///C:/Users/andra/Downloads/Gender%20Action%20Plan%20putting%20women%20and%20girls%20rights%20at%20the%20heart%20of%20the%20global%20recovery%20for%20a%20gender%20equal%20world.pdf).

⁵ Ibid.

V. Objektivat e SHE Solutions / AJO Zgjidhje

Për realizimin e misionit dhe vizionit të She Solutions, objektivat janë listuar më poshtë:

1. Fuqizimi, mbështetja dhe promovimi i grave në pozita vendimmarrëse

Objektiva Specifike 1.1 Rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe proceset vendimmarrëse

Nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje She Solutions kontribuon direkt në fuqizimin, mbështetjen dhe promovimin e grave në pozita vendimmarrëse. Kushtetuta e Kosovës⁶ dhe Ligji për Barazi Gjinore⁷ parashohin pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në politikë duke përfshirë dhe në vendimmarrje. Edhe pse ka pasur disa zhvillime në vitet e fundit, pjesëmarrja e grave në vendimmarrje kërkon zhvillim të mëtejshëm⁸. Ngritja e pjesëmarrjes së grave në pozita vendimmarrëse ndikon në trajtimin e çështjeve gjithëpërfshirëse duke avancuar barazinë gjinore dhe balancim të ndjeshmërisë gjinore në këto procese. SHE Solutions/AJO Zgjidhje do të promovojë shembujt më të mirë të grave si dhe storieve të tyre të suksesit përmes krijimit të produkteve multimediale të cilat do të publikohen në rrjetet sociale, të SHE Solutions, të institucioneve relevante dhe rrjetet sociale apo platformat e grave në pozitën vendimmarrëse për të pasur një audiencë më të madhe dhe target më të gjerë. Po ashtu, do të fuqizojë dhe mentoroj gratë dhe vajzat për të aplikuar në pozita vendimmarrëse nëpërmjet ofrimit të mundësive të rrjetëzimit, mentorimin, mbështetja peer to peer dhe trajnimeve.

Rezultatet e pritura:

- a. Rritja e numrit të grave në pozita vendimmarrëse⁹.
- b. Rritja e numrit të aplikimeve të grave për pozita vendimmarrëse.
- c. Rritja e vetëdijesimit rreth grave në pozita vendimmarrëse.
- d. Ngritja e vetëdijesimit të të gjithë studentëve pavarësisht gjinisë, etnisë, fesë, rreth anëve pozitive të përfaqësimit më të madh të grave në vendimmarrje, diversitetit gjinor si dhe përfitimeve që do të ketë shoqëria me integrimin e perspektivës gjinore në procese vendimmarrëse.
- e. Rritja e numrit të grave të mentoruara dhe të fuqizuara për të aplikuar në pozita vendimmarrëse.

Objektiva Specifike 1.2 Rritja e mbështetjes së grave asambleiste në nivelin komunal në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun

Me avancimin e teknologjisë dhe përdorimin masiv të rrjetve sociale paraqitet një potencial i madh për zhvillimin e politikëbërjes dhe informimit të publikut. Gjatë analizës së nevojave të performuar nga OJQ She Solutions është identifikuar një nevojë për trajnime të grave asambleiste në fushën e komunikimit masiv dhe platformat e mediave sociale për të u qasur me publikun dhe audiencën e tyre. Trajnime të tilla

⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>.

⁷ Ligji për Barazi Gjinore, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>.

⁸ Vendimmarrja e grave në sektorin publik dhe privat, Instituti Riinvest. Dhjetor 2022 <https://abgi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Hulumtimi%20Vendimmarrja%20e%20Grave%20n%C3%AB%20Sektorin%20Publik%20dhe%20Privat%20n%C3%AB%20Kosov%C3%AB.pdf>.

⁹ Një rezultat i rëndësishëm do të ishte një rritje e dukshme në numrin e grave që mbajnë poste vendimmarrëse në qeveri, borde të korporatave dhe role të tjera udhëheqëse. Kjo mund të përfshijë më shumë gra në pozita vendimmarrëse në politikë, duke avancuar drejtë një përfaqësimi më të larmishëm dhe gjithëpërfshirës në tryezën e vendimmarrjeve.

janë të pakta dhe më shumë në baza individuale dhe duhen paguar në kompani të ndryshme ku më shume bazohen në menaxhim të platformave dhe nuk kanë element politik. Rritja e kësaj mbështetjeje kontribuon direkt në rritjen e numrit të grave asambleiste dhe do kontribuonte në rritjen e shkathtësive të tyre. Mbështetje për gratë asambleiste në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun do të bëhet në bashkëpunim me Zyrat për Barazi Gjinore në komunat përkatëse dhe do të përfshijë trajnimin për hartimin e koncepteve dhe temave të cilat do t'i propozonin në takimet e kuvendeve komunale, për të folurit në publik, menaxhimin e rrjeteve sociale, komunikimin direkt me votuesit/ votueset e tyre. Po ashtu nëpërmjet trajnimit për gjuhën e trupit, kodin e sjelljes, kodin e veshjes.

Rezultatet e pritura:

- a. Përmirësimi i efektivitetit politik të grave asambleiste në nivelin komunal.
- b. Rritja e angazhimit dhe mbështetjes së votuesve ndaj grave asambleiste në nivelin komunal.
- c. Përfaqësimi dhe fuqizimi më i madh i grave në sferën politike në nivelin komunal.

Objektiva Specifike 1.3 Rritja e mbështetjes së grave deputete dhe fuqizimi i Grupit të Grave Deputete përmes menaxhimit të marrëdhënieve me publikun.

Grupi i Grave Deputete për momentin ka vetëm një platformë sociale për komunikim masiv me publikun¹⁰. Me rëndësinë e madhe që përbëjnë rrjetet sociale për informimin e publikut dhe ndjekjes masive të llogarive të ndryshme të rrjeteve sociale qëndron një potencial i pashfrytëzuar në tërësi për komunikim me publikun dhe ngritjen e informimit rreth kontributit dhe punës së GGD, dhe bashkëpunimit eventual të Grupeve në nivel rajonal. SHE Solutions/AJO Zgjidhja do të krijojë llogari në të gjitha rrjetet sociale në të cilat do të publikoheshin qëndrimet e Grupit të Grave Deputete dhe fjalimet e Grave deputete, reagimet për çështjet aktuale politike dhe krijimi i agjendës gjinore dhe ndërtimi i strategjisë së punës së GGD-së bazuar në këtë agjendë. Po ashtu do të organizojë konferenca tematike nga GGD-ja në koordinim me GGD-të rajonale dhe më gjerë, që do të shërbente në shkëmbimin e përvojave por edhe në ngritjen në nivel rajonal dhe më gjerë të çështjeve të caktuara e që ndihmojnë në avancimin e agjendës gjinore.

Rezultatet e pritura:

- a. Ngritja e visibilitetit dhe ndikimi i rritur i grupit të grave deputete.
- b. Rritja dhe zhvillimi i shkathtësive për promovimin e politikave që adresojnë pabarazitë gjinore.
- c. Ngritja e rrjetëzimit dhe bashkëpunimit për Grupet e Grave Deputete në nivel rajonal.
- d. Rriten mundësitë për shkëmbim të njohurive, rrjetëzim dhe bashkëpunim midis grave deputete, duke i ndihmuar ato të adresojnë sfidat e përbashkëta dhe të ndajnë praktikat më të mira në avancimin e çështjeve dhe përfaqësimit të grave në nivel rajonal.

2. Përkrahja dhe promovimi i grave në sektorin e sigurisë

Objektiva Specifike 2.1 Rritja e mbështetjes së grave në sektorin e sigurisë

Përqindja e grave në sektorin e sigurisë në Kosovë është ende një përqindje e ulët dhe mbështetja e grave specifikisht brenda këtij sektori do të kontribuonte në luftimin e stereotipeve gjinore që janë mjaft

¹⁰ Grupi i grave Deputete: https://m.facebook.com/people/Grupi-i-Grave-Deputete/100065001301520/?locale=hi_IN

prevalente në sektorin e sigurisë sikur sektor “për burrat”¹¹. Promovimi i grave në sektorin e sigurisë si ato në pozita vendimmarrëse ashtu edhe brenda sektorit, që janë të përfshira në administratë, pozita vendimmarrëse apo angazhim profesional në këtë sektor duke u fokusuar në Policinë e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Kjo do të arrihet përmes analizës së gjendjes aktuale, përmes hulumtimeve të politikave gjinore brenda këtij sektori duke përfshirë përfaqësimin, ngacmimin, ndërtimin e mekanizmave efektiv për promovimin e rolit të grave në sektorin e sigurisë, etj.

Rezultatet e pritura:

- a. Njohuri më e madhe në shoqëri dhe akterëve relevant rreth gjendjes aktuale të politikave gjinore në sektorin e sigurisë.
- b. Institucionet relevante informohen rreth sfidave të identifikuara dhe rekomandimet.
- c. Vetëdijesimi më i madh i shoqërisë dhe akterëve relevant rreth benefiteve të pjesëmarrjes së grave në sektorin e sigurisë.

Objektiva Specifike 2.2 Rritja e vetëdijesimit rreth kontributit të grave në sektorin e sigurisë

Paragjykimet dhe stereotipet shoqërore në Kosove, shpesh anashkalojnë ose nënvlerësojnë rolet e grave në siguri, duke penguar njohjen dhe avancimin e tyre. Përfaqësimi i kufizuar i grave në pozita udhëheqëse brenda institucioneve të sigurisë gjithashtu pengon avancimin e grave të tjera në këtë fushe në pozita vendimmarrëse. Tejkalmi i këtyre sfidave kërkon përpjekje për të adresuar paragjykimet sistematike, për të ofruar mundësi të barabarta dhe për të krijuar mjedise gjithëpërfshirëse që vlerësojnë dhe mbështesin kontributet e grave në këtë fushë kritike. Rritja e vetëdijesimit rreth kontributit të grave në sektorin e sigurisë do realizohet nëpërmjet arritjes së rezultateve të pritshme në vijim.

Rezultatet e pritura:

- a. Rritje e numrit të grave që hyjnë dhe marrin pjesë në role të ndryshme brenda sektorit të sigurisë
- b. Ngritja e vetëdijesimit të shoqërisë dhe akterëve relevant rreth benefiteve të pjesëmarrjes së grave në sektorin e sigurisë

VI. Monitorimi dhe Vlerësimi

Monitorimi përfshin mbledhjen e rregulltë dhe sistematike të të dhënave dhe informacionit për të ndjekur ecurinë e realizimit të aktiviteteve të strategjisë të përkufizuara më detajisht në Planin e Veprimit të She Solutions. Monitorimi përfshin përdorimin e treguesve të performancës, të cilët janë parametra të matshëm që ofrojnë dëshmi të progresit ose arritjeve. Monitorimi ndihmon në identifikimin dhe adresimin e problemeve që herët, gjë që mund të ndihmojë në përmirësimin e zbatimit të programit dhe arritjen e rezultateve më të mira. She Solutions do të krijojë dhe do të regjistrojë përfitueset/it e aktiviteteve të strategjisë, dhe të dhëna do ndahen sipas kërkesës së donatorëve dhe patjetër të përmbajnë informata rreth gjinisë, moshës, grupit etnik, nivelit të arsimit, dhe vendndodhjes. Informacioni regjistrohet për monitorimin dhe vlerësimin.

Vlerësimi përfshin një analizë më të thellë të programit ose ndërhyrjes. Ai përfshin vlerësimin sistematik dhe objektiv të ndikimit, efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së programit. Vlerësimet mund të bëhen në faza të ndryshme të programit ose ndërhyrjes, duke përfshirë gjatë hartimit, zbatimit dhe pas përfundimit

¹¹ Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë, Perceptimi i grave police për integrimin gjinor në policinë e Kosovës https://qkss.org/images/uploads/files/Women_in_Police_Alb_7_%281%29.pdf

të aktiviteteve. Vlerësimi ndihmon për të përcaktuar nëse programi po i arrin rezultatet e synuara dhe nëse po bën një ndryshim pozitiv.

Monitorimi dhe vlerësimi (M&V) janë mjete të rëndësishme që përdoren për të vlerësuar efektivitetin dhe ndikimin e programeve, projekteve, politikave dhe ndërhyrjeve. M&V ndihmon për të përcaktuar nëse janë arritur rezultatet e dëshiruara dhe nëse programi ose ndërhyrja po përmbush qëllimet dhe objektivat e tij.

SHE Solutions / AJO Zgjidhje do të monitoron zbatimin e planit të vetë strategjik përmes vlerësimit të përmbushjes së rezultateve të pritura të cilat janë paraparë për secilin objektiv të OJQ-së.

SHE Solutions, të gjeturat nga monitorimi i raporton para anëtarësisë në takimet e planifikuara vjetore si dhe do të i bashkangjet në raportin vjetor të punës.

M&V është e rëndësishme për disa arsye, duke përfshirë:

Llogaridhënie: M&V ndihmon për të siguruar që programet dhe ndërhyrjet janë të përgjegjshme ndaj palëve të interesuara dhe se po përmbushen pritshmëritë dhe kërkesat e tyre.

Mësimi: M&V ofron një mundësi për menaxherët e programit dhe palët e interesuara që të mësojnë nga përvojat e tyre dhe ta përdorin atë njohuri për të përmirësuar programet dhe ndërhyrjet e ardhshme.

Vendimarrja: M&V ofron informacione relevante që mund të përdoren për të marrë vendime të informuara në lidhje me hartimin, zbatimin dhe financimin e programit.

Përmirësimi: M&V mund të ndihmojë në identifikimin e dobësive në program ose ndërhyrje dhe të sugjerojë mënyra për ta përmirësuar atë.

M&V është një komponent thelbësor i menaxhimit efektiv të programit, dhe siguron informacion të vlefshëm që mund të përdoret për të përmirësuar performancën e programit, për të rritur përgjegjshmërinë dhe për të marrë vendime të informuara.

Monitorimi dhe gjurmimi i progresit në aktivitetet e She Solutions, veçanërisht ato që lidhen me fuqizimin dhe promovimin e grave, mund të arrihen nëpërmjet indikatorëve të ndryshëm. Këtu janë disa shembuj për secilën nga aktivitetet e specifikuar:

Indikatorët:

(1.1) Rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe proceset vendimarrëse

- # i grave në pozita vendimarrëse
- # i grave që aplikojnë në pozita vendimarrëse
- # i sondazheve rreth nivelit të vetëdijesimit për gratë në pozita vendimarrëse
- # i likes, comments dhe shares së sondazheve vetëdijësuese
- # i studentëve/eve të vetëdijësuar rreth rrëndësisë së pjesëmarrjes së grave në pozita vendimarrëse dhe;
- # i sesioneve mentoruese të ofruara
- # i grave të mentoruara ose të trajnuara për pozita udhëheqëse dhe;

- Kualiteti i komenteve nga gratë pjesëmarrëse në lidhje me perceptimin e tyre për fuqizimin dhe mbështetjen e dhënë

(1.2) Rritja e mbështetjes së grave asambleiste në nivelin komunal në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun

- # i grave asambleiste të mbështetura ose të trajnuara
- # i likes, comments dhe shares
- Cilësia e strategjive të komunikimit të zbatuara nga gratë asambleiste të trajnuara
- # i grave asambleiste të mbështetura ose të trajnuara
- % e angazhimit të publikut me gratë asambleiste duke përdorur analiza të matjeve Meta Business (Facebook dhe Instagram)
- Kualiteti i sondazheve ose komente nga audienca rreth postimeve të asambleisteve të trajnuara

(1.3) Rritja e mbështetjes së grave deputete dhe fuqizimi i Grupit të Grave Deputete përmes menaxhimit të marrëdhënieve me publikun

- Shikueshmëria dhe mbulimi pozitiv mediatik të Grupit të Grave Deputete
- # i fushatave të suksesshme të kryera për marrëdhënie me publikun
- Përmirësimi i perceptimit dhe ndërgjegjësimit të publikut për iniciativat e Grupit (mund të evaluohet me sondazhe apo pyetësorë)
- # i fushatave të suksesshme të kryera për zbatimin e ligjeve për barazi gjinore
- # i ndryshimeve legislative apo politikave të ndikuara nga gratë e trajnuara
- # dhe % e grave deputete që marrin pjesë në konferenca rajonale
- # i iniciativave dhe aktiviteteve nga bashkëpunimi rajonal i konferencave

(2.1) Rritja e mbështetjes së grave në sektorin e sigurisë

- Kualiteti i hulumtimit të hartuar dhe publikuar rreth politikave gjinore në sektorin e sigurisë
- # i takimeve informuese me institucionet relevante rreth sfidave të identifikuar
- # i personave të informuar rreth përfitimeve të pjesëmarrjes së grave në sektorin e sigurisë përmes kampanjës multimediale

(2.2) Rritja e vetëdijësimit rreth kontributit të grave në sektorin e sigurisë

- # i postimeve të grave të suksesshme në sektorin e sigurisë të hartuara dhe të postuara në tre platforma të ndryshme
- # i videove që shfaqin arritjet e grave në sektorin e sigurisë
- # i grave që hyjnë dhe marrin pjesë në role të ndryshme brenda sektorit të sigurisë
- # i personave të vetëdijësuar (burra dhe gra) rreth benefiteve të pjesëmarrjes së grave në sektorin e sigurisë

Për të gjitha këto aktivitete, është e rëndësishme vendosja e synimeve specifike, të matshme, të arritshme, të rëndësishme dhe të kufizuara në kohë (SMART) dhe të rishikohen rregullisht këto metrika dhe tregues për të vlerësuar progresin sipas planit të veprimit. Për më tepër, komentet, sondazhet dhe analiza kuantitative e shikueshmëria e mediave sociale nga audienca për gratë e përfshira në projekt, mund të ofrojnë njohuri të vlefshme për efektivitetin e aktiviteteve të ndërmarra.

VII. Plani i menaxhimit të rrezikut

Rreziqet e mundshme:

1. Shkurtime e financimit ose luhatjet e financimit nga donatorët
2. Rreziqet e pajtueshmërisë ligjore dhe rregullatore që lidhen me aktivitetet dhe operacionet e OJQ-së SHE Solutions / AJO Zgjidhje
3. Dëmtimi i reputacionit për shkak të publicitetit negativ ose aktiviteteve të diskutueshme
4. Shkeljet e sigurisë kibernetike dhe rreziqet e privatësisë së të dhënave
5. Rreziqet e shëndetit dhe sigurisë për stafin dhe vullnetarët

Vlerësimi mbi mundësitë dhe ndikimin e secilit rrezik:

1. Shkurtime e financimit ose luhatjet e financimit nga donatorët: Ndikim i madh
2. Rreziqet e pajtueshmërisë ligjore dhe rregullatore: Gjasa të vogla
3. Dëmtimi i reputacionit: Gjasa shumë të vogla
4. Shkeljet e sigurisë kibernetike dhe rreziqet e privatësisë së të dhënave: Mundësi të vogla
5. Rreziqet e shëndetit dhe sigurisë për stafin dhe vullnetarët: Me gjasa të ulëta, ndikim i moderuar

Strategjia për menaxhimin e rrezikut:

1. Shkurtime e financimit ose luhatjet e financimit nga donatorët: Duhet zhvilluar një strategji të larmishme financimi që përfshin burime të shumta financimi, duke përfshirë grantet qeveritare, donacionet private dhe sponsorizimet e korporatave. Sigurimi i një fondi rezervë për të ndihmuar në zbutjen e ndikimit të shkurtimeve të financimit.
2. Rreziqet e pajtueshmërisë ligjore dhe rregullatore: Sigurohemi që OJQ SHE Solutions / AJO Zgjidhje të jetë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse, duke përfshirë kërkesat e regjistrimit, detyrimet tatimore dhe kërkesat e raportimit. Zhvillojmë politika dhe procedura për të siguruar që aktivitetet e OJQ-së të kryhen në mënyrë ligjore dhe etike.
3. Dëmtimi i reputacionit: Kemi strategji komunikimi proaktive për të menaxhuar reputacionin e OJQ-së, duke përfshirë marrëdhëniet me median, menaxhimin e mediave sociale dhe komunikimet në rast të krizave.
4. Shkeljet e sigurisë kibernetike dhe rreziqet e privatësisë së të dhënave: Hartimi i një politike të sigurisë kibernetike që përfshinë procedurat për mbrojtjen e të dhënave të ndjeshme, trajnimin e stafit mbi praktikën më të mirë të sigurisë së të dhënave dhe rishikimin dhe përditësimin e rregullt të protokolleve të sigurisë. Zhvillimi i një plani për reagim ndaj shkeljes së të dhënave për të zbutur ndikimin e çdo shkeljeje të të dhënave që ndodh dhe përdorimin e këtyre të dhënave me pajtueshmërinë e secilit grup target të aktiviteteve të organizatës.
5. Rreziqet e shëndetit dhe sigurisë për personelin dhe vullnetarët: Zhvillojmë një politikë të shëndetit dhe sigurisë që përfshin procedurat për identifikimin dhe zbutjen e rreziqeve për personelin dhe vullnetarët. Ofrojmë trajnime të rregullta për stafin dhe vullnetarët mbi praktikën më të mirë të shëndetit dhe sigurisë.

Cilët janë përgjegjësitë në raport me këto rreziqe:

1. Shkurtime e financimit ose luhatjet e financimit nga donatorët: Drejtori Ekzekutiv dhe zyrtari financiar (drejtori financiar) do të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë së financimit, me mbështetjen e Bordit të Drejtoreve.
2. Rreziqet e pajtueshmërisë ligjore dhe rregullatore: Drejtori/ja Ekzekutiv/e do të jetë përgjegjës për të siguruar që OJQ SHE Solutions / AJO Zgjidhje të jetë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse.

3. Dëmtimi i reputacionit: Zyrtari për PR dhe Komunikim do të jetë përgjegjës për menaxhimin e Reputacionit të OJQ-së dhe zbatimin e strategjisë së komunikimit.
4. Shkeljet e sigurisë kibernetike dhe rreziqet e privatësisë së të dhënave: Menaxheri i TI-së do të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e politikës së sigurisë kibernetike dhe planit të reagimit ndaj shkeljes së të dhënave.
5. Rreziqet e shëndetit dhe sigurisë për personelin dhe vullnetarët: Asistenti/ja Administrativ/e dhe HR do të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e politikës së shëndetit dhe sigurisë.

VII. Procedurat e zbatimit, monitorimit dhe raportimit

1. Bordi i Drejtorëve do të marrë raporte të rregullta mbi aktivitetet e OJQ-së për menaxhimin e rrezikut dhe çdo ndryshim në këtë drejtim.
2. Drejtori Ekzekutiv si dhe stafi programatik do të jetë përgjegjës për monitorimin e efektivitetit të planit të menaxhimit të rrezikut dhe rekomandimin e përditësimeve sipas nevojës.

Trajnim i stafit për menaxhimin e rrezikut:

I gjithë stafi dhe vullnetarët do të marrin trajnime mbi politikën dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut të OJQ-së, duke përfshirë sigurinë e të dhënave, shëndetin dhe sigurinë, dhe pajtueshmërinë ligjore.

Rishikimi dhe përditësimi i planit:

Plani i menaxhimit të rrezikut do të rishikohet dhe përditësohet çdo vit ose më shpesh nëse ka ndryshime të rëndësishme në parashikimin e rrezikut ose në veprimtarinë e OJQ-së. Drejtoresha Ekzekutive do të jetë përgjegjës për udhëheqjen e procesit të rishikimit dhe përditësimit.

VIII. Gjithëpërfshirja

Duke u bazuar se përvojat e grave formësohen nga faktorë të ndërthurur si përkatësia etnike, statusi socio-ekonomik dhe moshë etj, She Solutions do të përshtat aktivitetet e saj për të adresuar nevojat specifike të komuniteteve të ndryshme. Para implementimit të aktiviteve do të bëhet vlerësimi gjithëpërfshirës i nevojave për të identifikuar dhe për t'i dhënë përparësi shqetësimeve specifike. Të gjitha programet dhe aktivitetet janë krijuar për të ofruar mbështetje të synuar, duke filluar nga iniciativat për zhvillimin e aftësive deri te mentorimi dhe trajnimi. She Solutions do të sigurojë që të gjithë njerëzit të përfshihen në programet dhe aktivitetet e implementuara në përputhje me misionin dhe objektivat, duke përfshirë njerëzit e të gjitha gjinive, moshave, etnive, orientimeve seksuale, religjioni, identiteteve gjinore, aftësive dhe profesionit. Gjatë zbatimit të kësaj strategjie, She Solutions do të sigurojë që aktivitetet të marrin parasysh nevojat dhe interesat e grupeve të ndryshme duke përdorur një qasje ndërseksionale. She Solutions do angazhohet në mënyrë aktive me gra me prejardhje të ndryshme, duke nxitur një mjedis gjithëpërfshirës duke përdorur vazhdimisht një lente ndërsektoriale duke mos lënë askënd prapa në përpjekjen për barazi gjinore dhe fuqizim. Kjo përfshin dhe synimin që me anë të zbatimit të aktiviteve të cekura më lartë të arrijë në zonat rurale dhe urbane, burra dhe gra të etnive, aftësive, moshave dhe rajoneve gjeografike të ndryshme.

IX. Operacionalizimi i Strategjisë

Organizata dhe organet e saja vendimmarrëse janë të përkushtuar të vendosin Strategjinë e SHE Solutions/Ajo Zgjidhje në veprim. Kjo do të realizohet përmes një grupi objektivash që formëson mënyrën se si është planifikuar, projektuar dhe zbatuar strategjia duke monitoruar dhe mësuar nga puna e organizatës duke përfshirë funksionet organizative ashtu edhe aktivitetet e ndryshme.

SHE Solutions/Ajo Zgjidhje do të integrojë barazinë gjinore në programet, politikat dhe praktikat e organizatës duke ofruar aktivitete dhe rezultate specifike sipas objektivave brenda këtyre fushave kryesore. Puna themelore për secilin prej këtyre objektivave do të kryhet gjatë pesë viteve të ardhshme, duke pranuar se shumë aktivitete kërkojnë investim afatgjatë ose të vazhdueshëm, duke përfshirë identifikimin e burimeve adekuate financiare dhe organizative.

Suksesi i kësaj strategjie do të varet edhe nga implementimi efektiv, monitorimi dhe përshtatja e vazhdueshme, dhe bashkëpunimi i fortë me palët e interesuara. Rishikimi dhe përditësimi i strategjisë duhet të jetë i rregulltë sipas nevojës për të qëndruar në linjë me ndryshimin e rrethanave dhe prioritetëve në fushën e fuqizimit të grave dhe ngritjes së përfaqësimit të tyre në pozita vendimmarrëse.

X. Plani i Veprimit

| OBJEKTIVI 1.1: Rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe proceset vendimmarrëse | | | |
|--|--|---------------------------------------|--|
| Aktiviteti | Rezultatet | Afati Kohor | Indikatori matës |
| 1.1.a Krijimi i përmbajtjes multimediale që nxjerr në pah gratë e suksesshme në pozitat vendimmarrëse ¹² | a. Rritja e numrit të grave në pozita vendimmarrëse. b. Rritja e numrit të aplikimeve të grave për pozita vendimmarrëse. c. Rritja e vetëdijesimit rreth grave në pozita vendimmarrëse. | Dhjetor 2023- Dhjetor 2024 | # i grave në pozita vendimmarrëse # i grave që aplikojnë në pozita vendimmarrëse # i sondazheve rreth nivelit të vetëdijesimit për gratë në pozita vendimmarrëse # i likes, comments dhe shares së sondazheve vetëdijësuese |
| 1.1.b Vetëdijesimi në shkollë dhe puna me rini: Bashkëpunimi me departamentet e arsimit në komuna të zgjedhura për të prezantuar gratë e suksesshme në pozita vendimmarrëse si modele për të frymëzuar vajzat e reja ¹³ | d. Ngritja e vetëdijesimit të të gjithë studentëve pavarësisht gjinisë, etnisë, fesë, rreth anëve pozitive të përfaqësimit më të madh të grave në vendimmarrje, diversitetit gjinor si dhe përfitimeve që do të ketë shoqëria me integrimin e perspektivës gjinore në procese vendimmarrëse. | Dhjetor 2023- Dhjetor 2024 | # i studentëve/eve të vetëdijësuar rreth rrëndësisë së pjesëmarrjes së grave në pozita vendimmarrëse dhe; # i sesioneve mentoruese të ofruara |
| 1.1.c Realizimi i programeve të fuqizimit për mundësitë e rrjetëzimit, mentorimit, mbështetjes nga kolegët dhe programet e trajnimit për të fuqizuar gratë që të aplikojnë për pozita vendimmarrëse | e. Rritja e numrit të grave të mentoruara dhe të fuqizuara për të aplikuar në pozita vendimmarrëse. | Dhjetor 2023- Dhjetor 2024 | # i grave të mentoruara ose të trajnuara për pozita udhëheqëse dhe; Kualiteti i komenteve nga gratë pjesëmarrëse në lidhje me perceptimin e tyre për fuqizimin dhe mbështetjen e dhënë |

¹² Publikimi në rrjetet sociale, në faqen e internetit të OJQ-së dhe në platformat e institucioneve përkatëse për të arritur një audiencë më të gjerë. Kjo do të krijohet dhe nga krijimi i hashtag apo challenges ku postimet të ripostohen dhe të krijohet një trend në rrjete sociale që të fitojë sa më shumë vëmendje dhe audiencë.

¹³ Këtu do të zhvillohet dhe materiali edukativ sikurse fletushka informuese.

| OBJEKTIVI 1.2: Rritja e mbështetjes së grave asambleiste në nivelin komunal në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun | | | |
|---|--|-------------------------------|---|
| Aktiviteti | Rezultatet | Afati Kohor | Indikatori matës |
| 1.2.a. Ofrimi i mbështetjes dhe mentorimit për gratë asambleiste në komunikim dhe marrëdhënie me publikun përmes bashkëpunimit me Zyrat për Barazi Gjinore në komuna. | a) Përmirësimi i efektivitetit politik të grave asambleiste në nivelin komunal; | Dhjetor 2023- Dhjetor 2024 | # i grave asambleiste të mbështetura ose të trajnuara # i likes, comments dhe shares |
| 1.2.b Zhvillimi i konceptit: Ofrimi i trajnimeve për hartimin e koncepteve dhe temave për mbledhjet e kuvendit komunal. | a) Përmirësimi i efektivitetit politik të grave asambleiste në nivelin komunal; | Dhjetor 2023- Dhjetor 2024 | Cilësia e strategjive të komunikimit të zbatuara nga gratë asambleiste të trajnuara |
| 1.2.c.Ofrimi i mentorimit dhe trajnimit për të folurit në publik, menaxhimin e mediave sociale dhe komunikimin e drejtpërdrejtë me votuesit duke përfshirë gjuhën e trupit, kodin e sjelljes dhe kodin e veshjes. | b) Rritja e angazhimit dhe mbështetjes së votuesve ndaj grave asambleiste në nivelin komunal; c) Përfaqësimi dhe fuqizimi më i madh i grave në sferën politike në nivelin komunal | Dhjetor 2023- Dhjetor 2024 | # i grave asambleiste të mbështetura ose të trajnuara % e angazhimit të publikut me gratë asambleiste duke përdorur analiza të matjeve Meta Business (Facebook dhe Instagram) Kualiteti i sondazheve ose komente nga audienca rreth postimeve të asambleisteve të trajnuara |

| OBJEKTIVI 1.3 Rritja e mbështetjes së grave deputete dhe fuqizimi i Grupit të Grave Deputete përmes menaxhimit të marrëdhënieve me publikun. | | | |
|--|---|-----------------------------|---|
| Aktiviteti | Rezultatet | Afati Kohor | Indikatori matës |
| 1.3.a Ofrimi i trajnimeve për marrëdhëniet me publikun: Sigurimi i mbështetjes dhe trajnimit të vazhdueshëm për gratë deputete në menaxhimin e marrëdhënieve me publikun | a) Ngritja e visibilitetit dhe ndikimi i rritur i grupit të grave deputete; | Janar 2025- Dhjetor 2026 | Shikueshmëria dhe mbulimi pozitiv mediatik të Grupit të Grave Deputete # i fushatave të suksesshme të kryera për marrëdhënie me publikun Përmirësimi i perceptimit dhe ndërgjegjësimit të publikut për iniciativat e Grupit (mund të evaluohet me sondazhe apo pyetësorë) |

| | | | |
|---|--|-------------------------|---|
| 1.3.b. Avokimi: Sigurimi i mbështetjes dhe trajnimit të vazhdueshëm për gratë deputete në avokimin për zbatimin e ligjeve për barazinë gjinore duke përmes të folurit në publik dhe mjeteve komunikuese teknologjike dhe kampanjave vetëdijesuese për audiencën | b) Rritja dhe zhvillimi i shkathtësive për promovimin e politikave që adresojnë pabarazitë gjinore | Janar 2025-Dhjetor 2026 | # i fushatave të suksesshme të kryera për zbatimin e ligjeve për barazi gjinore # i ndryshimeve legjislativ apo politikave të ndikuara nga gratë e trajnuara |
| 1.3.c Organizimi i konferenca tematike nga GGD-ja në koordinim me GGD-të rajonale për avancimin e agjendës gjinore | c) Ngritja e rrjetëzimit dhe bashkëpunimit për Grupet e Grave Deputete në nivel rajonal d) Rriten mundësitë për shkëmbim të njohurive, rrjetëzim dhe bashkëpunim midis grave deputete, duke i ndihmuar ato të adresojnë sfidat e përbashkëta dhe të ndajnë praktikën më të mira në avancimin e çështjeve dhe përfaqësimit të grave në nivel rajonal. Përkrahja dhe promovimi i grave në sektorin e sigurisë | Janar 2025-Dhjetor 2026 | # dhe % e grave deputete që marrin pjesë në konferenca rajonale # i iniciativave dhe aktiviteteve nga bashkëpunimi rajonal i konferencave |

| OBJEKTIVI 2.1: Rritja e mbështetjes së grave në sektorin e sigurisë | | | |
|--|--|---------------------------|---|
| Aktiviteti | Rezultatet | Afati Kohor | Indikatori matës |
| 2.1.a Hulimtimit i politikave gjinore: Hulimtime mbi politikave gjinore në sektorin e sigurisë, duke përfshirë çështjet e nënpërfaqësimit dhe sfidave, ngacmimeve etj. | a) Njohuri më e madhe në shoqëri dhe akterëve relevant rreth gjendjes aktuale të politikave gjinore në sektorin e sigurisë | Dhjetor 2026-Dhjetor 2027 | Kualiteti i hulumtimit të hartuar dhe publikuar rreth politikave gjinore në sektorin e sigurisë |
| 2.1.b Analiza e Sfidave: Identifikimi dhe dokumentimi i sfidave me të cilat përballen gratë në sektor dhe përpilimi i rekomandimeve të paraqitura tek institucionet relevante. | b) Institucionet relevante informohen rreth sfidave të identifikuar dhe rekomandimet | Dhjetor 2026-Dhjetor 2027 | # i takimeve informuese me institucionet relevante rreth sfidave të identifikuar |

| | | | |
|--|--|-------------------------------|--|
| 2.1.c Kampanja multimediale: Rritja e ndërgjegjësimit në shoqëri për përfitimet e pjesëmarrjes së grave në sektorin e sigurisë | c) Ngritja e vetëdijesimit të shoqërisë dhe akterëve relevant rreth benefiteve të pjesëmarrjes së grave në sektorin e sigurisë | Dhjetor 2026- Dhjetor 2027 | # i personave të informuar rreth përfitimeve të pjesëmarrjes së grave në sektorin e sigurisë përmes kampanjës multimediale |
|--|--|-------------------------------|--|

| OBJEKTIVI 2.2: Rritja e vetëdijesimit rreth kontributit të grave në sektorin e sigurisë | | | |
|---|--|-----------------------------|---|
| Aktiviteti | Rezultatet | Afati Kohor | Indikatori matës |
| 2.2.a Shfaqja e suksesit: Theksimi dhe promovimi i grave të suksesshme në sektorin e sigurisë përmes kanaleve të ndryshme. | a) Rritje e numrit të grave që hyjnë dhe marrin pjesë në role të ndryshme brenda sektorit të sigurisë | Janar 2028- Dhjetor 2028 | # i postimeve të grave të suksesshme në sektorin e sigurisë të hartuara dhe të postuara në tre platforma të ndryshme |
| 2.2.b Fushata e Vizibilitetit: Krijimi dhe publikimi i video përmbajtjeve që shfaqin arritjet e grave në sektorin e sigurisë. | b) Ngritja e vetëdijesimit të shoqërisë dhe akterëve relevant rreth benefiteve të pjesëmarrjes së grave në sektorin e sigurisë | Janar 2028- Dhjetor 2028 | # i videove që shfaqin arritjet e grave në sektorin e sigurisë # i grave që hyjnë dhe marrin pjesë në role të ndryshme brenda sektorit të sigurisë # i personave të vetëdijësuar (burra dhe gra) rreth benefiteve të pjesëmarrjes së grave në sektorin e sigurisë |


Përgjatë pesë viteve, është e rëndësishme të monitorohet dhe vlerësohet vazhdimisht efektiviteti i secilit program dhe të bëhen rregullime sipas nevojës për të arritur rezultatet e dëshiruara. Për më tepër, bashkëpunimi i rregullt me aktorët dhe institucionet përkatëse do të jetë vendimtar për suksesin e këtyre nismave. Plani i veprimit është i përgjithshëm dhe plani vjetor do të bëhet në fillim të secilit vit kalendarik në bazë të nevojave dhe mjeteve financiare në dispozicion.

Aneks A-Kodi i Mirësjelljes

1. Anëtarët, Bordi dhe të gjitha trupat tjera që funksionojnë në kuadër të OJQ-së SHE Solutions / AJO Zgjidhje janë të njoftuar me procedurat dhe politikat e punës dhe nga ata kërkohet që të respektojnë këto politika.
2. OJQ-së SHE Solutions / AJO Zgjidhje, ndalon çfarëdo lloj keqtrajtimi fizik apo verbal. Asnjë anëtarë apo individ në poste meanxhuese nuk ka të drejtë të diskriminojë apo ofendojë punonjës/sen tjetër, veçanërisht në bazë të moshës, racës, gjinisë, përkatësisë etnike, religjionit, origjinës apo orientimit seksual. Diskriminimi përfshin veprime që kanë për qëllim apo ndikojnë në trajtimin e individëve apo grupeve të caktuara në mënyrë jo të drejtë apo të pabarabartë, bazuar në qëndrime të pajustificuara, paragjytimeve dhe dallime.
3. OJQ-së SHE Solutions / AJO Zgjidhje, inkurajon të gjithë të anëtarët e saj që të marrin pjesë aktivisht në ngritjen e çështjeve dhe propozimin e zgjidhjeve lidhur me zhvillimin institucional dhe realizimin sa më të mirë të programeve të OJQ-së SHE Solutions / Ajo Zgjidhje” e cila ka misioni fuqizimin e grave në vendimmarrje.
4. Gjatë orarit të punës, stafi por edhe vullnetarët duhet të krijojnë atmosferë të pranueshme dhe tolerante të punës, me qëllim të rritje së efektivitetit të punës dhe kredibilitetit të organizatës.
5. Komunikimi në OJQ-së SHE Solutions / AJO Zgjidhje, do të jetë profesional, bazuar në mirësjellje dhe respekt të ndërsjellë.
6. Anëtarët dhe i gjithë stafi pa përjashtim, qofshin ata të punësuar apo vullnetar, ose individ në poste meanxheriale, këshillohen që të jenë të përkushtuar në realizimin me kohë dhe ne përputhje me detyrat e obligimet që i kanë në OJQ, të të gjitha detyrave. Ndërsa pas finalizimit të përgatisin raporte me shkrim të cilat do të ndihmojnë në monitorimin e ecurisë së punës dhe vlerësimin më të drejtë për nivelin e realizimit të projekteve, efikasitetin në punës dhe përmirësimin e gabimeve apo lëshimeve eventuale.

Aneks B-Organogrami

ORGANOGRAMI I OJQ-SË SHE SOLUTIONS



Këtu është një përshkrim i shkurtër të secilës pozitë:

1. Anëtarët e Bordit - Niveli më i lartë i grafikut organizativ tani tregon anëtarët e Bordit, të cilët janë përgjegjës për përcaktimin e drejtimit dhe strategjisë së përgjithshme të organizatës, duke ofruar mbikëqyrje dhe udhëzime për Drejtorin Ekzekutiv dhe duke siguruar që organizata është në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi dhe rregulloret. Ata gjithashtu mund të marrin pjesë në mbledhjen e fondeve dhe përpjekjet për shtrirjen e komunitetit.
2. Drejtori Ekzekutiv - Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për udhëheqjen e organizatës, përcaktimin e qëllimeve dhe drejtimeve strategjike, menaxhimin e operacioneve të përditshme dhe mbikëqyrjen e stafit dhe vullnetarëve. Drejtori Ekzekutiv i raporton Bordit dhe punon ngushtë me ta për të siguruar që organizata po përmbush misionin dhe objektivat e saj.
3. Zyrtari Financiar - Zyrtari Financiar është përgjegjës për menaxhimin e financave të organizatës, duke përfshirë buxhetimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar. Ata gjithashtu mbikëqyrin aktivitetet e mbledhjes së fondeve dhe sigurojnë që organizata është financiarisht e qëndrueshme dhe e aftë për të përmbushur misionin dhe objektivat e saj.
4. Asistent Administrativ / HR - Ky pozicion është përgjegjës për mbështetjen e funksioneve të përditshme administrative dhe të burimeve njerëzore të organizatës. Kjo mund të përfshijë detyra të tilla si menaxhimi i orareve, organizimi i dokumenteve, koordinimi i takimeve, futja e stafit dhe vullnetarëve të rinj dhe mbajtja e të dhënave të personelit. Ky pozicion mund të jetë gjithashtu përgjegjës për menaxhimin e përfitimeve, listës së pagave dhe funksioneve të tjera të lidhura me Burimet njerëzore.
5. Studiuesi - Hulumtuesi është përgjegjës për kryerjen e kërkimit, mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e informacionit në lidhje me misionin dhe objektivat e organizatës. Ato ofrojnë njohuri dhe rekomandime për Drejtorin Ekzekutiv dhe Bordin e Drejtorëve për të informuar vendimmarrjen dhe zhvillimin e programit.
6. Vullnetarët - Vullnetarët janë individë që dhurojnë kohën dhe aftësitë e tyre për të mbështetur misionin dhe aktivitetet e organizatës. Ata mund të ndihmojnë me detyra të tilla si planifikimi i ngjarjeve, mbledhja e fondeve, shtrirja e komunitetit dhe puna administrative. Vullnetarët nuk janë anëtarë të stafit, por ata luajnë një rol të rëndësishëm për të ndihmuar organizatën të arrijë qëllimet e saj.
7. Anëtarët - Anëtarët janë individë ose organizata që mbështesin misionin e organizatës dhe kontribuojnë financiarisht ose në mënyra të tjera. Ata mund të marrin përfitime të tilla si aksesi në ngjarje ose botime të veçanta dhe mund të kenë një rol në proceset vendimmarrëse të organizatës. Anëtarësimet janë një mënyrë që organizata të angazhohet me mbështetësit e saj dhe të ndërtojë një komunitet të fortë rreth misionit të saj.
8. Bashkëthemeluesit - Bashkëthemeluesit e organizatës paraqiten si një shtresë e veçantë në grafikun organizativ. Ata zakonisht janë përgjegjës për nisjen e organizatës dhe formësimin e vizionit dhe strategjisë së saj fillestare. Në varësi të madhësisë dhe strukturës së organizatës, bashkëthemeluesit mund të shërbejnë edhe në pozita të tjera drejtuese.